

Hapet thirrja për shprehje interesi nga bashkitë për pjesëmarrje në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) në Shqipëri.

Synimi i Thirrjes:

Qëllimi i thirrjes është përzgjedhja e **4 bashkive** në Shqipëri, të cilat nuk kanë qënë pjesë e fazave të mëparshme të ReLOaD, të cilave do t'iu ofrohet mbështetje teknike për të adoptuar një qasje transparente, të orientuar nga zhvillimi dhe të bazuar në projekt për financimin e OSHC-ve. Ky proces do të kontribuojë në forcimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE, si dhe në forcimin e OSHC-ve dhe qytetarëve për të marrë pjesë aktive në proceset e vendim-marrjes në nivel vendor.

Objektivat e thirrjes:

Sikurse dhe në fazat e mëparshme të programit, objektivi specifik i programit është të forcojë bashkëpunimin midis bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Ballkanin Perëndimor, të kontribuojë në një mjedis më mbështetës për OSHC-të, bazuar në financime publike transparente, një kuadër ligjor mbështetës, si dhe rritje të angazhimit civil në hartimin e politikave, zbatim dhe monitorim. Duke qënë në fazën e fundit, programi synon të kapitalizojë dhe të rrisë rezultatet, si dhe të sigurojë qëndrueshmëri të praktikave të mira të prezantuara gjatë zbatimit të tij.

Kriteret e Thirrjes:

- **Kritere të detyrueshme** - të gjitha kriteret e detyrueshme duhet të përmbushen si një parakusht për pjesëmarrje në program. Aplikimet e bashkive që nuk përmbushin këto kritere **nuk do konsiderohen më tej.**
- **Kriteret e pikëzimit** - bashkitë që përmbushin kriteret e detyrueshme do të vlerësohen me pikë dhe do të renditen në përputhje me matricën e pikëzimit (**Aneksi 2 i Udhëzuesit**)
- **Kriteret e konvergjencës** – përfaqësojnë aspekte shtesë që nuk vlerësohen me pikë por që merren në konsideratë në përzgjedhjen përfundimtare të bashkive.

Kush mund të aplikojë:

Në këtë thirrje publike, mund të aplikojnë të gjitha bashkitë në Shqipëri që përmbushin kriteret e kësaj thirrjeje dhe që nuk kanë marrë pjesë në fazat e mëparshme të programit (Bashkitë partnere në ReLOaD1 dhe ReLOaD2 ishin: Dibër, Durrës, Elbasan, Kamëz, Kavajë, Korçë, Kukës, Lezha, Librazhd, Lushnjë, Patos, Përmet, Përrenjas, Roskovec, Saranda, Shkodër, Tiranë, dhe Tropojë). Bashkitë e përzgjedhura duhet të marrin përsipër përgjegjësinë për të alokuar në mënyrë transparente fonde për projekte të OSHC-ve (bazuar mbi Metodologjinë LOD: Metodologjia LOD për Alokimin e Fondeve për Organizata të Shoqërisë Civile <https://www.undp.org/albania/publications/metodologjia-alokimin-e-fondeve-organizatat-e-shoqerise-civile>). Gjithashtu, duhet të angazhohen për të zbatuar kritere dhe metoda transparente në përdorimin e burimeve publike dhe për të nxitur një qasje pjesëmarrëse për përcaktimin e përparësive vendore.

Avantazhet e pjesëmarrjes në programin ReLOaD3:

Përmes këtij partneriteti me ReLOaD3, bashkitë do të përmirësojnë punën e tyre, kapacitetet e stafit, bashkëpunimi me OSHC-të dhe do bëhet më transparent dhe efektiv

në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe do të kontribuojë më tej në përmirësimin e rezultateve zhvillimore. Pjesëmarrja në projektin ReLOaD3 do t'iu ofrojë bashkive:

- Mbështetje financiare për projekte të OSHC-ve që adresojnë nevojat e komunitetit të bashkisë.
- Mbështetje teknike për aplikimin e metodologjisë LOD për alokimin e fondeve për OSHC-të.
- Ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të bashkive në menaxhimin e ciklit të projektit.
- Shkëmbim eksperience dhe promovimi i praktikave të mira me bashki të tjera në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- Ngritje kapacitetesh për OSHC-të në bashkitë partnere përmes trajnimeve dhe mentorimeve;
- Mbështetje për projekte të OSHC-ve që ofrojnë shërbime cilësore dhe të shumëllojshme në përputhje me planet vendore strategjike të zhvillimit dhe nevojat e komunitetit.
- Inkurajim dhe mbështetje për nisma që rrisin pjesëmarrjen qytetare në vendim-marrje;
- Mbështetje për të forcuar dhe promovuar pjesëmarrjen qytetare në komunitetet vendore;
- Mbështetje për të organizuar dialog midis bashkive, OSHC-ve dhe qytetarëve.

Cili është buxheti i thirrjes:

Grant për çdo bashki: nga **80,000 USD** deri në **130,000 USD**.

Bashkia duhet të kontribuojë me të paktën **25%** të bashkëfinancimit.

Gjithsej për 6 bashki (katër bashki partnere të reja dhe dy bashki partnere të përzgjedhura nga bashkitë përfituese në fazat e ReLOaD1 dhe ReLOaD2) me **770,000 USD**.

Si bëhet aplikimi:

Të gjitha bashkitë që përmbushin kriteret e detyrueshme të thirrjes publike mund ta shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në programin ReLOaD3 duke dorëzuar:

- Formularin e Plotësuar të Aplikimit (të firmosur nga Kryetari i Bashkisë/person i autorizuar dhe të vulosur)
- **Letrën e interesit** (të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë dhe të vulosur) - Aneksi 1
- **Të gjithë dokumentacionin mbështetës** sikurse shpjegohet në Pjesën II e Udhëzuesit.

Dokumentat duhet të dorëzohen në 1 kopje origjinale + 1 kopje elektronike në USB, në zarf të mbyllur dhe ose mund të dërgohen përmes postës së regjistruar / shërbimit postar privat ose personalisht në adresën:

United Nations Development Programme in Albania
Regional Programme on Local Democracy in the Western Balkans 3 (ReLOaD)
Rruga e Bogdaneve, Eurocol Building, kati i 7-të, Tiranë, Shqipëri

Kur do të zhvillohen Seksionet e Informimit

Janë planifikuar 3 seksione informuese për të ndihmuar bashkitë e interesuara:

- 29 Prill 2025 – Online (11:00 – 12:00)
Lidhja Zoom:
<https://undp.zoom.us/j/88293413298?pwd=ZN7t0533jbnHmiazDZo6qHLUmbMCeQ.1>
Meeting ID: 882 9341 3298 | Passcode: 207357
- 22 Maj 2025 – Tiranë, UN House, kati i dytë (11:00 – 13:00)
- 03 Qershor 2025 – Online (11:00 – 12:00)
Lidhja Zoom:
<https://undp.zoom.us/j/88152441537?pwd=ZVdagH4mJ3Brhe5RqhdbAECxFo0QHP.1>
Meeting ID: 881 5244 1537 | Passcode: 393351

Nëse nevojiten informacione dhe sqarime të mëtejshme, bashkia mund të kontaktojë me UNDP-in në Shqipëri nëpërmjet e-mail: reload.al@undp.org duke iu referuar programit ReLOaD3 në titullin e e-mailit. Pyetjet mund të parashtrohen deri në **pesë ditë** para afatit të fundit për dorëzimin e aplikacioneve. Përgjigjet e pyetjeve do të dorëzohen me shkrim jo më vonë se **3 (tri) ditë** pune pas marrjes.

Kur është afati i fundit:

Afati për dorëzim: **13 qershor 2025, ora 15:00.**

Aplikimet e dorëzuara me postë duhet të kenë vulën postare që konfirmon se aplikimi u dorëzua brenda afatit të fundit zyrtar. Aplikimet e dorëzuara pas afatit të fundit zyrtar sipas orarit që tregon dëftesa e pranimit të objekteve postare nuk do merren në konsideratë.

Linku i Thirrjes:

<https://www.undp.org/albania/news/call-expression-interest-municipalities-participate-regional-programme-local-democracy-western-balkans-3-reload3-albania>